

MANUAL PERDORIMI

# DAISY COMPACT M



## INFORMACION

Ky dokument ofron një mundësi për të kuptuar se si të punoni me një pajisje fiskale. Ju mund të programoni të gjithë parametrat e pajisjes fiskale. Pajisja fiskale mund të ofrojë nxjerre raporte të ndryshme dhe informacione të nevojshme për ju. Kjo pajisje është e aftë të punojë si kase por edhe si printer duke u lidhur me një program menaxhimi.

Ky manual përdorimi duhet të mbajë parasysh kushtet e mirembajtjes sipas manualit të mirembajtjes së pajisjes

### Ushqimi me energji

Pajisja fiskale Compact M është projektuar për të punuar me përshtatës USB

**⚠ Perpara se të filloni punë , të karikohet pajisja jo më pak se 2 ore**

### Temperatura e operimit

Temperatura nga  $-15^{\circ}\text{C}$  deri në  $+45^{\circ}\text{C}$

### Permasat

Permasat e ECR: 195 x 180 x 65 mm

Pesha: 460 g

### Zevendesimi i rulnit të letres

Kjo pajisje mban rulon letre me permasat e mëposhtme:

- Gjerësia e letres 57mm
- Diametri i rulnit max 55mm

### Parametrat:

Ushqimi me energji: 5V

Tastiera : 31 butona

Departamente: 50 +8

Artikuj : 30000

Operatorët: 20

Pajisja fiskale ndizet duke mbajtur shtypur butonin **O** . Pajisja mund te veproje ne 7 menu. Me butonin **M** mund te levizni nga nje menu ne tjetren.

1. SHITJE
2. LEXIM
3. Z RAPORT
4. PROGR
5. MF
6. PC
7. TRAINIM

Per te hyre ne menu duhet te shtypet password **9999** dhe te konfirmohet me butonin **CLK**

## SHITJE


### SHITJE ME CMIM FIKS

Kjo menyre shitje perdoret ne rastin kur ne kase artikujt jane rregjistruar me cmime.

Duke shtypur disa here butonin **M** shkojme tek menu **SHITJE**

1. Vendosim password **9999** dhe pastaj shtypim butonin **CLK**
2. Vendosim sasine e artikullit (pshb.1) dhe shtypim butonin **QTY**
3. Shtypim kodin e artikullit (pshb. 1) dhe shtypim butonin **PLU**
4. Per te mbyllur faturen shtypin butonin **TOTAL** (TL)

Per te shtuar ne fature me shume se nje artikull, pa e mbyllur faturen , perserisim veprimet nga 2 deri tek 3 dhe pasi kemi perfunduar shtimin e te gjithë artikujve ne fature shtypim **TOTAL**

 *Nese duam te anullojme faturen , gjithmone para se te shtypet **TOTAL** , shtypim butonin **VD (VOID)***

Per te printuar kupon dublikat shtyp direkt pas printimit te fatures **99** ,pastaj **TL**

### SHITJE ME CMIM TE NDRYSHEM


Kjo menyre shitje perdoret ne rastin kur cmimi qe vendosim eshte i ndryshueshem .

Duke shtypur disa here butonin **M** shkojme tek menu **SHITJE**

1. Vendosim password **9999** dhe pastaj shtypim butonin **CLK**
2. Vendosim sasine e artikullit (pshb.1) dhe shtypim butonin **QTY**
3. Vendosim cimin e artikullit (pshb 100) dhe shtypim butonin **CLK**

4. Shtypim kodin e artikullit (pshb. 1) dhe shtypim butonin **PLU**
5. Per te mbyllur faturen shtypin butonin **TOTAL** (TL)

Per te shtuar ne fature me shume se nje artikull, pa e mbyllur faturen , perserisim veprimet nga 2 deri tek 4 dhe pasi kemi perfunduar shtimin e te gjithë artikujve ne fature shtypim **TOTAL**

 *Nese duam te anullojme faturen ,gjithmone para se te shtypet **TOTAL** , shtypim butonin **VD (VOID)***

Per te printuar kupon dublikat shtyp direkt pas printimit te fatures **99** ,pastaj **TL**


## **SHITJE ME FATURE TVSH**

Kjo menyre shitje perdoret ne rastin kur duam qe ne fature te shfaqet nr. i fatures .

Duke shtypur disa here butonin **M** shkojme tek menu **SHITJE**

1. Vendosim password **9999** dhe pastaj shtypim butonin **CLK**
2. Vendosim Nr. Serial te fatures (pshb.1514) dhe shtypim butonin **STL**
3. Vendosim sasine e artikullit (pshb.1) dhe shtypim butonin **QTY**
4. Vendosim cimin e artikullit (pshb 100) dhe shtypim butonin **CLK**
5. Shtypim kodin e artikullit (pshb. 1) dhe shtypim butonin **PLU**
6. Per te mbyllur faturen shtypin butonin **TOTAL** (TL)

Per te shtuar ne fature me shume se nje artikull, pa e mbyllur faturen , perserisim veprimet nga 3 deri tek 5 dhe pasi kemi perfunduar shtimin e te gjithë artikujve ne fature shtypim **TOTAL**

 *Nese duam te anullojme faturen ,gjithmone para se te shtypet **TOTAL** , shtypim butonin **VD (VOID)***

Per te printuar kupon dublikat shtyp direkt pas printimit te fatures **99** ,pastaj **TL**

## **LEXIM**

Ne kete menu mund te lexohet gjendja e arkes dhe raporte te tjera si : raport plu, raport me department, raport me sasi stock etj.

Duke shtypur disa here butonin **M** shkojme tek menu **LEXIM**

**Per te kontrolluar gjendjen e arkes veprojme si me poshte**

1. Vendosim password **9999** dhe pastaj shtypim butonin **CLK**
2. Shtypim butonin **TOTAL**

## MBYLLJE DITORE

Ne menu Z Raport printohet mbyllja e xhiros ditore e cila ruhet ne memorjen fiskale.

Duke shtypur disa here butonin **M** shkojme tek menu **Z RAPORT**

1. Vendosim password **9999** dhe pastaj shtypim butonin **CLK**
2. Shtypim butonin **PLU** per te printuar artikujt e shitur
3. Shtypim butonin **TOTAL** per te bere mbylljen

 Mbyllja ditore do te kryhet automatikisht mbrenda 24 oreve nga shitja e pare .

## MBYLLJE PERODIKE

Ne kete menu nxirret informacion nga memorja fiskale:

- Sipas nr te raportit
- Sipas dates

Per te printuar raport periodik sipas dates te detajuar veprohet si meposhte:

Duke shtypur disa here butonin **M** shkojme tek menu **MF**

1. Vendosim password **9999** dhe pastaj shtypim butonin **CLK**
2. Shtypim butonin **1** dhe pastaj butoni **STL**
3. Vendosim daten e fillimit pshb dd/mm/vv. 140819
4. Shtypim butonin **QTY**
5. Vendosim daten e fundit pshb dd/mm/vv. 200819
6. Shtypim butonin **VD**

Per te printuar raport periodik sipas dates si shume veprohet si meposhte:

Duke shtypur disa here butonin **M** shkojme tek menu **MF**

1. Vendosim password **9999** dhe pastaj shtypim butonin **CLK**

2. Shtypim butonin **11** dhe pastaj butoni **STL**
3. Vendosim daten e fillimit pshb. 140819
4. Shtypim butonin **QTY**
5. Vendosim daten e fundit pshb. 200819
6. Shtypim butonin **VD**

## PC

Kjo menu te lejon te perdoret pajisja fiskale si printer fiskal nepermjet nje program menaxhimi.

Pajisja fiskale lidhet me kompjuterin me nje kabull USB

Per te hyre ne menu PC

Duke shtypur disa here butonin **M** shkojme tek menu **PC**

1. Vendosim password **9999** dhe pastaj shtypim butonin **CLK**

## LEXIM NGA QSHKE

Ne menu LEXIM ose Z RAPORT mund te behet leximi i QSHKE

Nxjerrja e informacionit behet ne tre menyra:

- Sipas nr te kuponit
- Sipas nr te raportit
- Sipas dates

## **SIPAS NR TE KUPONIT**

Duke shtypur disa here butonin **M** shkojme tek menu **LEXIM**

- 1.** Vendosim password **9999** dhe pastaj shtypim butonin **CLK**
- 2.** Shtypim njekoheisht **ALT+TOTAL**
- 3.** Shtypim butonin **1** dhe pastaj **STL**
- 4.** Vendosim daten pshb. 140819
- 5.** Shtypim butonin **QTY**
- 6.** Vendosim nr e kuponit pshb. 2
- 7.** Shtypim butonin **+%**
- 8.** Vendosim nr e kuponit te fundit pshb.3
- 9.** Shtypim butonin **-%**

## **SIPAS NR TE RAPORTIT**

Duke shtypur disa here butonin **M** shkojme tek menu **LEXIM**

- 1.** Vendosim password **9999** dhe pastaj shtypim butonin **CLK**
- 2.** Shtypim njekoheisht **ALT+TOTAL**
- 3.** Shtypim butonin **2** dhe pastaj **STL**
- 4.** Vendosim nr e raportit pshb.1
- 5.** Shtypim butonin **QTY**
- 6.** Vendosim nr e raportit pshb. 2
- 7.** Shtypim **VD**

## SIPAS DATES

Duke shtypur disa here butonin **M** shkojme tek menu **LEXIM**

1. Vendosim password **9999** dhe pastaj shtypim butonin **CLK**
2. Shtypim njekoheisht **ALT+TOTAL**
3. Shtypim butonin **3** dhe pastaj **STL**
4. Vendosim daten **140819**
5. Shtypim butonin **QTY**
6. Vendosim daten **150819**
7. Shtypim **VD**

## PROGRAMIM I ARTIKUJVE

Duke shtypur disa here butonin **M** shkojme tek menu **PROG.**

1. Vendosim password **9999** dhe pastaj shtypim butonin **CLK**
2. Shtypim kodin e artikullit qe duhet te shtojme dhe shtypim **PLU**
3. Shtypim butonin **STL**
4. Vendosim cmimin pshb. 10 dhe konfirmojme me **STL**
5. Shtypim butonin **STL** per te kaluar tek parametri i radhes
6. Vendosim nr e departamentit dhe shtypim **STL**
7. Shtypim butonin **STL** per te kaluar tek parametri i radhes
8. Shkruajme emrin e artikullit duke perdorur tabelen 1.

Per te kaluar nga germa te vogla ne germa te medha shtypim butonin **QTY**

9. Shtypim **STL** per te konfirmuar emertimin dhe shtypim perseri **STL** per te vazhduar me parametrin tjetër



**10.**Vendos barcode nese ka ose shtyp **STL** per te kaluar ne parametrin tjetër

**11.**Sasia default është 9999999 shyp **STL** per te perfunduar

Pere te dale nga programimi i artikujve shtyp butonin **M**

Tabela.1

7 .,`?! 4 GHI/ghi	8 ABCÇ/abcç 5 JKL/jkl 2 TUV/tuv	9 DEFË/defë 6 MNO/mno 3 WXYZ/wxyz 0 hapesire % + = \$ ^ QTY
----------------------------	--	--